



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:211695

Datë: 28.02.2024

Numri i dokumentit: 05385390

KE.nr.749/23

PROCESVERBAL I SEANCËS PËRGATITORE

I përpiluar më datë 28.02.2024 në GJYKATËN KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë,
Departamenti për Çështje Ekonomike

Gjyqtari:
Florent Zeqiri

Zyrtare Ligjor:
Miranda Murturi

Paditësi : Nike Innovate me seli në USA

I padituri : NTP Adhurimi me seli në Ferizaj

Lënda e kontestit: markë tregtare.

Filloi në 11:00
Seanca është publike

Gjyqtari e hap seancën, publikon lëndën e shqyrtimit dhe përbërjen e gjykatës.

Palët pa vërejtje.

Konstatohet se prezent janë:

Për paditësin: Avokate F.G.V., sipas autorizimit,

Për të paditurin: Pronari A.Sh., i identifikuar sipas letërnjoftimit me nr. personal

Meqenëse janë plotësuar kushtet ligjore për mbajtjen e seancës së sotme, Gjykata merr këtë:

AKTVENDIM

Seanca e sotme përgatitore mbahet.

U lexua padia e datës 05.10.2023.

Ftohen përfaqësuesit e palëve ndërgjyqësve që të deklarohen:

I autorizuari i paditësit deklaron: pala paditëse deklaron kane arritur marrëveshje per zgjidhjen e këtij kontesti. i padituri pranon se ka bere shkelje te markave tregtare NIKE me importimin e pa autorizuar te produkteve te cilat bartin shenjat NIKE. I padituri merr përsipër qe te shkatërrojë 600 pale atlete qe mbajnë marka tregtare Nike me shpenzimet e tij dhe t'i siguroje paditësit te gjitha provat e duhura për këtë shkatërrim.

I padituri deklaron: konfirmoje se me palën paditëse kemi arritur një marrëveshje jashtë gjyqësore te cilën kërkojmë qe gjykata ta lejoje ne këtë seance ku konstatohet se ne kemi bere shkelje te markave tregtare te paditësit dhe marrim obligimin për shkatërrimin e 600 pale atlete qe mbajnë markën tregtare Nike.

Andaj, palët njëzëri propozojnë qe te arrihet ky pajtim gjyqësor;

PAJTIM GJYQESOR

- I. Vërtetohet se i padituri NTP Adhurimi me seli në Ferizaj përmes importit te 600 palë atlete kanë shkelur markën tregtare te paditësit me fjale NIKE me nr. Regjistrim 2394 dhe markën figurative me nr. Regjistrim 2395 dhe markën AIR JORDAN me nr. regjistrimin 2393, ndërsa pjesa tjetër e mallrave te ndaluara nga Dogana e Kosovës prej 768 palë atlete lirohen për qarkullim të lirë sepse te njëjtat nuk i shkelin markat tregtare te paditësit.
- II. Obligohet i padituri NTP Adhurimi me seli në Ferizaj që me shpenzimet e tij të shkatërroj 600 palë atlete si në pikën I të këtij dispozitivi, brenda afati prej 30 ditësh nga dita e arritjes se këtij pajtimi gjyqësor, nën kërcënimin e përmbarimit.
- III. Në rast të mos përmbushjes së obligimit sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij pajtimi gjyqësor, OBLIGOHET i padituri NTP Adhurimi me seli në Ferizaj që të mbuloj shpenzimet që do të shkaktohen për shkatërrimin e mallit -600 palë atlete.
- IV. Obligohet i padituri NTP Adhurimi me seli në Ferizaj që të mbuloj të gjitha shpenzimet e magazinimit sipas faturës për 600 palë atlete, në afat prej 30 ditësh nga dita e arritjes së këtij pajtimi gjyqësor.
- V. I ndalohet te paditurit NTP Adhurimi me seli në Ferizaj që në të ardhmen të përmbahet nga importimi, ruajtja, ofrimi për shitje, shitje apo shpërndarje të mallit që shkel markat tregtare të paditësit NIKE si në pikën I te dispozitivit.

VI. Shpenzimet e procedurës i bartë secila palë veç e veç.

Pas kësaj gjykata merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **APROVOHET** pajtimi gjyqësor i arritur ndërmjet palëve ndërgjyqëse. Vendimi i lartcekur merr formën e vendimit të plotfuqishëm dhe të titullit ekzekutiv.

Përfundoi në orën 11:15

Palët prezente e lexuan dhe e nënshkruan procesverbalin pa vërejtje.

Përfaqësuesja e paditësit

Përfaqësuesi i të paditurit

Vë r t e t o j n ë:

Zyrtarja Ligjore

Gjyqtari
